



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY-SUHAREKË
SKUPSTINA OPŠTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 41, të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", e në mbështetje të nenit 29, lidhur me nenin 32, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, 09.12.2025, miratoi këtë:

V E N D I M

Për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës në Suharekë

Neni 1

Me këtë vendim z. **Bexhet KUÇI** i lindur me datën 27.03.1968 në Suharekë, tani me vendbanim të përhershëm në Rr. "Jetë Balia" në Suharekë me profesion Master i shkencave ekonomike, zgjedhet, **Kryesues i Kuvendit të Komunës në Suharekë.**

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Suharekës, janë të përcaktuara me Ligjin Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008" dhe Statutin e Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008 dhe aktet tjera Ligjore dhe nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 3

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës zgjidhet për një mandat të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr- 016-73916
Me datë 09.12.2025



Anëtar i vjetër i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI